

Sarandë, më 07.12.2023

PROCESVERBAL - TIPI I KONTRATËS - SHËRBIME

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROKURIMIT: *“Azhornime te tokes Bujqesore”*

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Sherbime topografike 71351810-4

VLERA E FONDIT LIMIT: 10 833 333 (Dhjetë milion e teteqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre)leke **Monedha, pa TVSH**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Sarandë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26 dhe 30, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.1.1 Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriterëve të Përgjithshme (Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP dhe nenin 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % të vlerës së përlllogaritur/fondit limit të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" si dhe nenin 65, të Ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, si dhe VKM nr. 922, datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike".

Përcaktimi i vlerës është bërë brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe paraqitja e një dëshmie të lëshuar nga administrata tatimore vërteton besueshmërinë dhe kapacitetet financiare që ka një operator ekonomik ofertues nëpërmjet xhiros të realizuar në një nga këto tre vitet e fundit. Është e rëndësishme që ofertuesi para se të dorëzojë ofertën të kuptojë dhe të vlerësojë aftësitë/mundësitë e tij që lidhen me kapitalin e nevojshëm për ekzekutimin me sukses të një kontrate.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2020, 2021, 2022, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve në nenin 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në 77, pika 3, e LPP, dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, dhe nenin 104 të Ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, Ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" të ndryshuar, si dhe Ligjit nr. 10091 datë 5.3.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" i ndryshuar.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate (apo shumatores së fondit limit të loteve, nëse kontrata është e ndarë në lote dhe ofertohet për më shumë se një lot).

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben autoritetit kontraktor për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet në vlerën prej 40% të fondit limit, në afat dhe me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme është një “kompetencë thelbësore”, ndaj operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore/polisa sigurimi për ta provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.3.2 Licenca profesionale të operatorit për realizimin e objektit të kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore:

a) Operatori duhet të jetë i licencuar dhe të zoterojë një licencë aktive në Projektim në Kat. 8a – Rilevime Inxhinierike, Kat. 8b – Rilevime Inxhinierike Kadastrale dhe Kat. 8c – Sisteme GIS , 8d – Bazamente Gjeodezike dhe 8e- Projektim fotogrametrik dhe hartografik

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, Ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimiti” të ndryshuar, Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” si dhe pika 4, neni 41 I VKM 285/2021. Kategoritë janë kërkuar bazuar

në listen e zërave dhe vlerat e punimeve. Licencat janë të lidhura ngushtësisht me zerat e punimeve të ndërtimit. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret, që autoriteti i vlerëson të nevojshme, për sa kohë ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

- Kjo do të vërtetohet nepermjet paraqitjes së Licenses

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastruktura dhe Energjise, (ose Ministrise kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale te individeve dhe subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit të projektimit të ndërtimit dhe mbikeqyrje e kolaudikimit të punimeve miratura me VKM- ne, Nr.759, date 12.11.2014 i ndryshuar. Mosparaqitja në këto forme është kusht skualifikues.

b) Operatori duhet të ketë aktivitet minimumi tre vjet në objektin e veprimtarisë së tij të këtyre punimeve ose shërbimeve që kanë lidhje me objektin e kontratës që prokurohet pra të ofrojë shërbime në fushën e gjeodezisë, hartografisë, topografisë, regjistrime fillestare etj..

Kjo duhet të vërtetohet me:

- Profilin e kompanisë

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”. Kjo kërkesë i jepet besueshmeri Autoritetit Kontraktor për kryerjen sa më mirë të këtij shërbimi.

2.3.3 Operatori duhet të ketë të punësuar, prej një periudhe (shtator 2023-ntor 2023), minimumi 10 (dhjetë) specialiste me eksperiencë në fushat e nevojshme për realizimin e regjistrimit fillestar, të vërtetuar me dokumentacionin përkatës (CV, Diplome, Certifikate, Liçensat kur kërkohen, Çertifikatat kur kërkohen), detajuar si më poshtë:

a) Të pakten 1(nje) Projekt Menaxher me experience në projekte të ngjashme. Projekt Menaxheri duhet të ketë mbaruar studimet në degët: Inxhinieri elektronike, Gjeodezi, Informatike ose degë të ngjashme.

b) Operatori duhet të ketë të punësuar jo më pak se 1 (një) specialist hartograf të liçensuar që zoteron Liçensat aktive në projektim të Kat. 8a – Rilevime inxhinierike, Kat. 8b – Rilevime Inxhinierike Kadastrale, Kat.8c – Sisteme GIS dhe 8d-Bazamente Gjeodezike si dhe sisteme GIS,8e – Projektim fotogrametrik dhe hartografik, me experience në projekte të ngjashme regjistrimi fillestar të pasurive të paluajtshme

c) Operatori duhet të ketë të punësuar të pakten 2 teknik topograf të aftë për të përdorur pajisjet gjeodezike

d) Operatori duhet të ketë të punësuar jo më pak se 2 (dy) Jurist/e me eksperiencë në fushën e Regjistrimit Fillestar të Pasurive të Paluajtshme

e) Operatori duhet të ketë të punësuar jo më pak se 4 ekspert gjeodetë, dy prej të cilëve duhet të jenë të specializuar apo certifikuar për përdorim të Droneve, për përpunimin e të dhënave gjeohapsinore. Kjo të deshmohet me certifikate orgjinale ose fotokopje të noterizuara, të lëshuara nga organizma të akredituar certifikues, të njohura nga Republika e Shqipërisë .

Pra ,

Për secilin prej specialisteve Operatori/et Ekonomike duhet te paraqesin:

- kualifikimet arsimore (diplomat),
- CV
- Licencat ku kerkohen
- Certifikata kur kerkohen

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e personelit kryesor në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 9. Formulari I vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit.

Në këtë rast, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet te kete jo me pak se 10 punonjës te siguar për çdo muaj për periudhën (korrik 2023-shtator 2023). Si dëshmi për fuqinë punëtore do të dorëzohen dokumentet si më poshtë;

- Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore për periudhën (korrik 2023-shtator 2023) shoqëruar me listëpagesat sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni tatimor.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

-Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e personelit kryesor në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 9. Formulari I vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Në përcaktimin e numrit te punonjësve specialisti i fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si **volumet dhe kategoritë e punimeve**, kualifikimi i punonjësve, **grafiku i punimeve (sipas grafikut të miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e ASHK)**, **zërat e punimeve dhe orët e punës sipas Kodit të Punës** etj.

2.3 5. Operatori duhet zoteroje pajisjet (ne pronesi ose me qera) minimalisht si me poshte:

a) Printer/Skaner me rezolucion te larte për skanimin e dokumenteve të pasurive të paluajtshme.

Skanerat duhet të skanojnë me ngjyra dokumente të formatit A4 e A3.

b) Miminumi 3 GPS

c) 1 Total Station, me karakteristika minimale: saktësisë së lartë 1".

2 Total Station me karakteristika mesatare

d). 2 DRON profesional, te specializuar per fotogrametri, me kamera dixhitale (njeri prej tyre me rezolucion min.36 megapixel), ne pronesi (te shoqerohet me faturen tatimore te blerjes) ose me qira(te shoqerohet me kontraten perkatese te qirase ,(njeri prej tyre te jete me RTK Positioning)

e) Skaner Lidar dhe Kamer RGB, me karakteristika minimale, saktësi centimetrike (metode pozicionimi PPK); -kend skanimi (Field of View FOV) te pakten 100°

-Largesi matese (Instrument Range) te pakten 120m.

Dronet duhet te shoqerohen me skeden teknike ku te duken qarte parametrat e kerkuar ne DST

Paisjet sipas pikes 2.3.4 duhet te shoqerohen me certificate kalibrimi- kolaudimi te 6 muajve te fundit.

-Operatori duhet vërtetojë që ai ka në pronësi ose qera pajisjet hardware (pikat a- e). Në rastin e pronësisë ai duhet te paraqesë dokumentet vërtetuese si fatura dhe/ose vërtetimi doganor dhe në rastin qe ato do te merren me qera duhet të paraqitet kontrata për marrjen me qera të këtyre pajisjeve si dhe dokumentet e pronesisë mbi keto pajisje të qeradhenesit.

Argumentimi: : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikes 4, neni 41 I VKM 285/2021. Azhornimi i pronave të nje fshati me sipërfaqe te mëdha, kërkon paisjet e duhura dhe cilësore ne menyre qe te permbushen kriteret profesionale dhe ato kohore. Duke qene se ne terren do jene se paku dy grupe, per secilin grup nevojitet nje/dy GPS dhe 3 Total Station per kryerjen e matjeve te sakta te ndertesave/objekteve. Po ashtu per secilin grup, ne menyre qe matjet dhe materialet te grumbullohen e te perpunohen brenda afateve, nevojitet nga nje Dron professional si dhe nje lidar , per terrene te paarritshme dhe te mbuluara me bimesi .**Pas perpunimit te fotove, mund te gjenerohen ortofoto te gjithë zones,e cila ndihmon ne perpunimin dhe perpilimin e hartave ne zyre.** Duke qene se fluturimet do te kryhen ne lartesi mbi 100m (per shkak te sipërfaqes se madhe) , nevojitet kamera profesionale me rezolucion jo me pak se 36 mpx, ne menyre qe ne ortofoto te dallohen detaje te ndryshme si gardh, kufinj prone, apo lumenje te cilet mund te jene te paarritshem ne rruge tokesore gjate matjeve.Po ashtu paisja Lidar kerkohe e cilesise se larte dhe me karakteristika te mira per te arritur matje te sakte dhe distanca sa me te largeta.

2.3.6 Të pakten 2 Inxhinierë te certifikuar per pedorim te Droneve, per perpunimin e te dhenave gjeohapsinore. Kjo te deshmohe me certificate orgjinale ose fotokopje e noterizuar, te leshuar nga organizma te akredituar certifikues, te njohur nga Republika e Shqiperise . (Kjo kerkese do te konsiderohet e permbushur gjate fazes se ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet te paraqese perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afatit te ankimimit dokumentin e deklaruar si më lart).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikes 4, neni 41 I VKM 285/2021.

Për përpunimin e të dhëave gjeohapsinore dhe sidomos punët fotogrametrike, nevojitet 2 inxhinierë të specializuar mbi përdorimin e Dronëve dhe përpunimin e materialeve (fotografike) të përfuara nga fluturimet. Një inxhinier nevojitet për fotografimet në terren dhe një inxhinier për përdorimin e softwareve specifik për përpunim fotogrametrik.

2.3.7 Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikata të vlefshme:

- Çertifikatë ISO 9001/2015 për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë ose ekuivalent të cilat duhet të jenë të vlefshme në periudhën kur zhvillohet tenderi, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 44, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Për vetë natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, të mjedisit dhe shëndeteti të sigurisë në punë. Kjo çertifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përpara kohës do të pranohet edhe ekuivalentja e saj dhe i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Neni 79 i Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, parashikon se autoriteti kontraktor mund të kërkojë çertifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

Neni 44, pika 1 dhe pika 3 i Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, përcakton se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin çertifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”

**Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, tëVKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

NJËSIA E PROKURIMIT: